



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 125, 126, 127, 128 dhe 129 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Policinë e Republikës së Kosovës nr. 04/L-076, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet dizajni i uniformës policore, uniformës së punës, uniformës solemne dhe uniformës së togut të nderit të Policisë së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen Politikat Strategjike për Shërbimin Postar për vitin 2013-2017.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Politikave Strategjike nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen Koncept-dokumentet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik si në vijim:
 - 1.1. Koncept-dokumenti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-184 për Energjinë;
 - 1.2. Koncept-dokumenti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë dhe
 - 1.3. Koncept-dokumenti për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-201 për Energjinë Elektrike.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 02/03 të datës 09 mars 2011

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë nr. 02/03 i datës 09 mars 2011, ku pika 2. e vendimit zëvendësohet me tekstin në vijim: Komisioni Qeveritar për Privatizimin e PTK-së përbëhet nga:

- 1.1. Fadil Ismajli, Ministër i Zhvillimit Ekonomik,
- 1.2. Mimoza Kusari-Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë,
- 1.3. Fefmi Mujota, Ministër i Infrastrukturës,
- 1.4. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenës Sociale,
- 1.5. Besim Beqaj, Ministër i Financave,

kryesues;
anëtare;
anëtar;
anëtar;
anëtar.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 02/04 të datës 11.03. 2011

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë nr. 02/04 i datës 11.03. 2011, për themelimin e Komisionit Qeveritar për privatizimin e Kompanisë Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me energji elektrike.
2. Pika 2. e vendimit nr.02/04 të datës 11.03.2011, zëvendësohet me tekstin si në vijim:

2.1. Fadil Ismajli, Ministër i Zhvillimit Ekonomik,	kryesues;
2.2. Besim Beqaj, Ministër i Financave,	anëtar;
2.3. Mimoza Kusari-Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë,	anëtare;
2.4. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenës Sociale,	anëtar;
2.5. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,	anëtar;
3. Pika 3. e vendimit nr.02/04 të datës 11.03.2011, zëvendësohet me tekstin si në vijim: "Komisioni Qeveritar do të vazhdoj monitorimin në procesin e post-privatizimit të kompanisë, distribucionit dhe furnizimit me energji elektrike"

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 05/18 të datës 08.06.2011

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë nr. 05/18 i datës 08.06.2011, ku pika 2. e vendimit zëvendësohet me tekstin në vijim: Komisioni i Ministrave për Ndërmarrjet Publike përbëhet nga:

- | | |
|--|-----------|
| 1.1. Fadil Ismajli, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, | kryesues; |
| 1.2. Besim Beqaj, Ministër i Financave, | anëtar; |
| 1.3. Mimoza Kusari-Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë, | anëtare; |
| 1.4. Fefmi Mujota, Ministër i Infrastrukturës, | anëtar; |
| 1.5. Dardan Gashi, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, | anëtar; |

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Z. Osman Hajdini, emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Z. Blerim Sokoli, emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i Rekomandon/Kërkon Presidentes së Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për Ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Z. Agim Çeku për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura me marrëveshjen ndërkombëtare për Statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve respektive.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Presidentes së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohen shpronësimet dhe vlerësimet shtesë me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdarë, Sektori 9, Zonat Kadastrale, Mazgit dhe Llazarevë të Komunës së Obiliqit dhe Zonat Kadastrale Bërnice e Poshtme, Bardhosh dhe Trudë të Komunës së Prishtinës, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden Zonat Kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për

kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e këtij vendimi.

6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Gjilanit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500,000.00 (pesëqind mijë) euro për financimin e shpronësimeve të Projektit të lumit "Mirusha" - Komuna e Gjilanit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara, me kod 232-180 dhe transferohen në programin Zyra e Kryetarit, nën-programi me kod 88604, kategoria ekonomike shpenzime kapitale.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Gjilanit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/133
Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Z. Driton Gashi, emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/133

Datë: 05.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa z. Jakup Rexhepi për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 20,000.00 (njëzetë mijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara, dhe barten në xhirollogarinë e z. Jakup Rexhepi nr. 1407000006744580 në bankën komerciale, Banka Ekonomike.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë